

Plani i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor

Rritja e konvergencës socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor me BE-në dhe përsheptimi i reformave të BE-së



TETOR 2024

#WesternBalkans
#EUEnlargement
#WBGrowthPlan

PLANI I ZGJERIMIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR BAZOHET NË 4 SHTYLLA

- 1** Rritja e integritimit ekonomik me Tregun Unik të Bashkimit Evropian
- 2** Rritja e integritimit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor përmes Tregut të Përbashkët Rajonal
- 3** Përsheptimi i reformave themelore
- 4** Rritja e ndihmës financiare

Plani i zgjerimit do të zbatohet nëpërmjet një instrumenti të ri financimi: **Propozimi prej 6 miliardë € i Reformës për Zgjerimin e Ballkanit Perëndimor.**



€6 miliardë

€2 miliardë grante

€4 miliardë kredi

2024-2027










Shtylla

1

AFRIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR ME TREGUN E PËRBASHKËT TË BE-SË

BE-ja do të hapë zona të caktuara të tregut të përbashkët të BE-së për partnerët e Ballkanit Perëndimor përpara anëtarësimit duke sjellë përfitime të prekshme për qytetarët e tij. Partnerët e Ballkanit Perëndimor do të duhet të ndërmarrin reforma themelore, sipas *acquis* dhe të përmbushin detyrimet e tyre në kuadër të Tregut të Përbashkët Rajonal.

Vëmendje do të kenë shtatë fushat e mëposhtme prioritare:

-  Lëvizja e lirë e mallrave
-  Lëvizja e lirë e shërbimeve dhe punëtorëve
-  Qasje në Zonën e Pagesave në Euro
-  Lehtësimi i transportit rrugor
-  Integrimi dhe dekarbonizimi i Tregjeve të Energjisë
-  Tregu i Unifikuar Digjital
-  Integrimi në zinxhirët e furnizimit industrial

Shtylla

2

THELLIMI I INTEGRIMIT EKONOMIK RAJONAL BRENDA BALLKANIT PERËNDIMOR

Zhvillimi i një Tregu të Përbashkët Rajonal është thelbësor për dy arsye:

- për të zhblokuar potencialin ekonomik të rajonit, për të krijuar mundësi për biznesin dhe punëtorët dhe për ta bërë Ballkanin Perëndimor një vend më tërheqës për investitorët evropianë. Një Treg i Përbashkët Rajonal do të shtonte 10% të PBB-së të rajonit, në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor me kalimin e kohës.
- bazuar në miratimin dhe zbatimin e standardeve të BE-së, është një hap drejt Tregut Unik të BE-së.

Shtylla

3

PËRSHPEJTIMI I REFORMAVE THEMELORE

Për të rritur konvergjencën socio-ekonomike, partnerët e Ballkanit Perëndimor do të duhet të ndërmarrin reforma në fushat bazë.

Secili partner i Ballkanit Perëndimor do të implementojë një Agjendë Reformash me një sërë reformash prioritare të ndara në piketa, të ashtuquajturat “kushtet e pagesës”. Përfundimi i tyre do të nxisë lirin e fondeve nga Plani i ri i Zgjerimit.

Përsheptimi i reformave do të sjellë:

- Përmirësimin e rritjes ekonomike duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal;
- Ndhimën ndaj partnerëve të Ballkanit Perëndimor për të ecur përpara drejt anëtarësimit në BE

Shtylla 4

RRITJA E NDIHMËS FINANCIARE

Lehtësia e Reformës dhe Zgjerimit prej 6 miliardë € për vendet e Ballkanit Perëndimor kombinon grantet dhe huatë. Ky instrument i ri do të plotësojë ndihmën aktuale financiare në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III).

Lehtësia do të ofrojë një mbështetje financiare totale maksimale prej 6 miliardë eurosh për 2024-2027 të përbërë prej:

- 2 miliardë euro grante në pritje të marrëveshjes për rishikimin e Kornizës Financiare Shumëvjeçare
- 4 miliardë euro kredi me koncesion të lartë



SI DO TË FUNKSIONOJË LEHTËSIA E RE?

Të paktën **50%** e shumës totale (grante dhe kredi) do të shkojë për investime përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP). Nga shumta e mbetur e kredive do të përfitojnë Qeveritë në Ballkanin Perëndimor. **Çlirimi i çdo fondi** do të varet nga **përparimi** në zbatimin e masave të përfshira në **Agjendat e Reformës**.

Pagesat do të bëhen dy herë në vit, në bazë të kërkesave të paraqitura nga partnerët e Ballkanit Perëndimor dhe pas verifikimit nga Komisioni për arritjen e kushteve relevante të pagesës, parakushteve dhe kushteve të përgjithshme, si stabiliteti makrofinanciar, menaxhimi i shëndoshë i financave publike, transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit.

Nëse kushtet e pagesës nuk plotësohen, Komisioni do të pezullojë ose do të zbrësë një shumë përkatëse nga pagesa. Partneri i Ballkanit Perëndimor do të ketë 1-2 vjet kohë për të përmbushur kushtet, në të kundërt shumta do të rishpërndahet mes të tjerëve në vitet në vijim.

